



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr. 026/2020

Nr. Protokolli: 77/2020

|        |                                                            |
|--------|------------------------------------------------------------|
| Për:   | "€ EURO-GROUP " SH. P.K., Rr. Brigada 123, 23000, Suharekë |
| Kopje: | z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës          |
| Nga:   | Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit                       |
| Lënda: | VENDIM                                                     |
| Datë:  | 13.08.2020                                                 |

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 09.08.2020 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: **"€ EURO-GROUP " SH. P.K., Rr. Brigada 123, 23000, Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndertimi i rrugeve locale me karakter regjional-viset rurale ne Suharekë**, me Nr. të Prok: **624-20-2759-5-2-1 & 624-020-055-521**, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e datës 06.08.2020 e Operatorit Ekonomik: **"€ EURO-GROUP " SH. P.K., Rr. Brigada 123, 23000, Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndertimi i rrugeve locale me karakter regjional-viset rurale ne Suharekë**, me Nr. të Prok: **624-20-2759-5-2-1 & 624-020-055-521**, kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 04.08.2020 të publikuar në platformen elektronike.
2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 04.08.2020
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 09.08.2020, ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **"€ EURO-GROUP " SH. P.K., Rr. Brigada 123, 23000, Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndertimi i rrugeve locale me karakter regjional-viset rurale ne Suharekë**, me Nr. të Prok: **624-20-2759-5-2-1 & 624-020-055-521**, kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 04.08.2020 të publikuar në platformen elektronike  
Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vlerësuar drejt, duke analizuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar sipas DT, dhe se me datë: 23/07/2020 ka Kërkuar **"CITIM "me anë të Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht, për POZICIONI III 1 Mbistruktura e rrugës pika 3.5 furnizimi ,transporti , dhe montimi i anesorve 100\*22\*15 cm nga betoni i klases C30/37 , në qmim**

të përfshihen të gjitha punimet deri në përfundim të pozicionit keni ofruar qmim 1 euro. po në të njëjtin pozicion 3.5 prapë keni ofruar një qmim për 1 euro .Në pozicionin 3.6 keni ofruar qmim për 5 euro për m<sup>2</sup> Në pozicionin 2.3 keni ofruar qmim në vlerë prej 50 euro qmim jo normalisht të ulët . Pozicioni III Mbistruktura e rrugës në pikën 5 dhe 6 ju keni ofruar qmime jo normalisht të ulëta”.

Pas përgjigjes tuaj me shkrim të datës 25.07.2020 Autoriteti Kontraktues e ka vlersuar jo bindës për pozicionet të lart shënuara si dhe dokumentacioni i ofruar nuk është real me çmimet në treg e po ashtu profatura për asfalt është lëshuar nga kompania EUROMALL SH.P.K, i verifikuar në ARBK në pronësi nga familjari i OE EUROGRUP i cili është i njohur për Autoritetin Kontraktues dhe far nuk merret me prodhimin dhe furnizim të asfaltit e po ashtu profatura e lëshuar me datë 16.02.2020 nga kjo kompani e ofruar si dëshmi është jo e qëndrueshme dhe jo bindëse dhe se ka disproporcion në llogaritje totale si dhe TVSH, andaj AK-Suharekë vlerëson se kjo dëshmi nuk është bindëse.

Ndërsa sa i përket Pertendimit 1 se AK – Suharekë ju ka eliminuar se në certifikatën e biznesit i mungon veprimtaria përkatëse 4211, kjo Nuk Qëndron. Ju mund të verifikoni në platformën elektronike e-prokurimi të formulari B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të Datës : 04/08/2020.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

